VENDIM
Nr. 312, datë 24.5.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 222, DATË 23.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE PËR NJOHJE TË SË DREJTËS SË KOMPENSIMIT TË PRONËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 37, të ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 222, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në kreun I bëhen këto ndryshime:

a) Në pikat 1 dhe 2, fjala "... ligjorë ..." hiqet;

b) Në shkronjën "a", të pikës 5, emërtimi "Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" zëvendësohet me "Agjencia Shtetërore e Kadastrës".

2. Pika 6, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Kur ATP-ja konstaton mangësi në dokumentacionin shoqërues të kërkesës, njofton kërkuesin me postë të porositur që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, të plotësojë pasaktësitë. Kur kërkuesi nuk ka marrë dijeni për mangësitë në dokumentacionin shoqërues të kërkesës, ATP-ja kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për vendbanimin e kërkuesit, me qëllim kryerjen e njoftimit përmes postës së porositur. Kur njoftimi nuk është i mundur ose vendbanimi i kërkuesit nuk është i njohur, njoftimi bëhet me shpallje në selinë e ATP-së, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet prona, objekt pretendimi, si dhe në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin. Njoftimi vlerësohet i kryer pas 10 (dhjetë) ditëve nga data e shpalljes, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.".

3. Në kreun III bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 12, emërtimet "Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale" zëvendësohen me "Agjencinë Shtetërore të Kadastrës";

b) Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"18. ATP-ja, pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave të paraqitura për njohje të së drejtës së kompensimit, merr vendim për pranimin ose rrëzimin e kërkesës. Në rast pranimi, ATP-ja me të njëjtin vendim, sipas rastit, përcakton:

a) sipërfaqen që kompensohet fizikisht, brenda pronës së njohur subjektit të shpronësuar, kur pronat e paluajtshme janë të lira, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", të ndryshuar;

b) vlerësimin financiar të së drejtës së kompensimit të njohur, që nuk mund të kompensohet, sipas shkronjës "a", të kësaj pike.".

c) Pas pikës 18 shtohen pikat 18/1, 18/2 dhe 18/3, me këtë përmbajtje:

"18/1. Kompensimi fizik, brenda pronës së njohur subjektit të shpronësuar, sipas shkronjës "a", të pikës 18, të këtij kreu, kryhet sipas rregullave të përcaktuara në pikat 26/3, 26/5, 26/6 dhe 26/9, të kreut IV/A, të vendimit nr. 223, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave", të ndryshuar. Vlerësimi financiar i së drejtës së kompensimit, sipas

shkronjës “b”, të pikës 18, të këtij kreu, kryhet sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar.

18/2. Vendimi i ATP-së për njohjen e së drejtës për kompensim fizik përcakton pronën në kufij, sipërfaqe dhe në pozicion gjeografik të saktë dhe regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

18/3. Në rastet kur evidentohen mbivendosje të pronave të pretenduara për njohje dhe kompensim, ATP-ja vijon procedurat për njohjen dhe kompensimin e pronës për pjesën që nuk ka mbivendosje. Palët mund të zgjidhin rastin me mbivendosje me marrëveshje me njëri-tjetrin ose në rrugë gjyqësore.”.

II. Ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama